

VENDIM
Nr.1207, datë 11.12.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA RIKONSTRUKSIONI I
RRUGËS NGA KOPSHTI ZOOLOGJIK NË TAKIM ME RRUGËN “SAMI FRASHËRI”,
NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga rikonstruksioni i rrugës nga Kopshti Zoologjik në takim me rrugën “Sami Frashëri”, në bashkinë e Tiranës.

2. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që jepet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 44(dyzet e katër) m² tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 052 336 (dy milionë e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 052 336 (dy milionë e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e vitit 2009.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Tiranës.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Tiranës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë, 44(dyzet e katër) m², tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Tiranës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO
TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS NGA KOPSHTI
ZOOLOGJIK NË TAKIM ME RRUGËN “SAMI FRSHËRI”, NË BASHKINË E TIRANËS**

NR.	EMËR, MBIEMËR	SIPËRFAQJA TRUALL M²	ÇMIMI LEKË	VLERA LEKË	DOKUMENTI I PRONËSISË	ZONA E KADASTRAVE
1.	NAIM TARJA	44	46 644	2 052 336	VËRTETIM PRONËSIE	8270
	TOTALI	44		2 052 336		

